



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Ftesë për shprehje të Interesit

Të nderuar,

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit bashkë me Ministrinë e Financave dhe përkrahje të projektit të Asistencës Teknike të BE-së, kanë hartuar Rregulloren për vendosjen e kriterëve dhe standardeve për financim të OJQ-ve.

Ministria e Financave gjatë vitit 2017, ka aprovuar Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, e cila është e aplikueshme për të gjitha organizatat buxhetore. Gjatë vitit 2017 janë organizuar një seri trajnimesh, duke përfshirë edhe trajnime në vendin e punës për zyrtarët e institucioneve që janë përgjegjëse për aplikimin e rregullores.

Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisja të Mirë, synon që të vazhdojë me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike përmes organizimit të trajnimeve, duke përfshirë edhe trajnimet në vendin e punës për zyrtarët e institucioneve publike. Prandaj, kërkojmë shprehjen e interesit nga institucionit juaj që ekspertët të punojnë me zyrtarët e institucionit tuaj në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e kërkesave të rregullores. ZKM/ZQM bashkë me ekspert planifikon që të ofrojë trajnime në punë për 3 ministri dhe 5 komuna sa i përket kërkesave të rregullores së mësipërme. Ju lutem që institucioni juaj të shpreh interesin deri më **datën 05 qershor 2018**. Shprehjen e interesit ju lutem ta bëni në e-mail adresën trendeline.dreshaj@rks-gov.net.

Duke pas parasysh, interesimin e madh të institucioneve, ju lutem që krahas shprehjes së interesit, të na përshkruani edhe nevojën për trajnim në vendin e punës, numrin e përafërt të zyrtarëve që do të marrin pjesë, duke përfshirë thirrjet publike që planifikoni të organizoni gjatë vitit 2018, dhe kapacitetet institucionale të institucionit tuaj.

Përveç trajnimeve në vendin e punës ne planifikojmë një raund tjetër të punëtorive të përbashkëta për të gjitha ministritë dhe komunat për të mundësuar diskutime lidhur me mësimet dhe përvojat nga viti i parë i zbatimit të rregullores, ndërsa datat e trajnimit do ju komunikohen shumë shpejtë.

Duke ju falënderuar paraprakisht, ju dëshirojmë suksese në punë!

Me respekt,